



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.253/ 10 prot.

Datë 06.03.2024

V E N D I M
Nr.245/2024

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 06.03.2024, mori në shqyrtim çështjen me,

Objekt: Mbi zbatimin e vendimit të KPP nr.214/2024, datë 24.01.2024, për procedurën e prokurimit “E hapur” me Nr. REF-93857-01-26-2024 me objekt “Shërbimet e përmirësimit dhe mirëmbajtjes së software-ve”, me fond limit 13,980,000.00 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 14.02.2024, nga autoriteti kontraktor Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Durrës Sh.A.

Autoriteti Kontraktor: Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Durrës Sh.A me adresë: L.17 Rr. “Dalip Peza”, Durrës.

Ankimues: Operatori ekonomik “Primus Albania” SHPK me NIPT L42202028V dhe adresë: Rruga “Margarita Tutulani”, pallati Viridario 1, Tiranë

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:

I

Rrethanat e çështjes

I.1. Në datën 24.01.2024, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr.214/2024 ku vendosi:

1. *Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “Primus Albania” SHPK, për procedurën e prokurimit “E hapur” me Nr. REF-93857-01-26-2024, me objekt “Shërbimet e përmirësimit dhe mirëmbajtjes së software-ve”, me fond limit 13,980,000.00 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 14.02.2024, nga autoriteti kontraktor Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Durrës Sh.A.*
2. *Autoriteti kontraktor të anulojë procedurën e prokurimit objekt-ankimi.*
3. *Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.*
4. *Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues “Primus Albania” SHPK.*
5. *Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.*
6. *Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

I.2. Me shkresën nr. 179/37 prot., datë 28.02.2024 protokolluar me tonën nr. 253/7 prot., datë 01.03.2024 autoriteti kontraktor njofton se e ka zbatuar vendimin e KPP-së nr. 214/2024 datë 24.01.2024 duke anuluar procedurën e prokurimit “E hapur” me Nr. REF-93857-01-26-2024, me objekt “Shërbimet e përmirësimit dhe mirëmbajtjes së software-ve”, me fond limit 13,980,000.00 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 14.02.2024, nga autoriteti kontraktor Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Durrës Sh.A.

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton:

II.1. Me shkresën nr. 179/37 prot., datë 28.02.2024 protokolluar me tonën nr. 253/7 prot., datë 01.03.2024 autoriteti kontraktor njofton se e ka zbatuar vendimin e KPP-së nr. 214/2024 datë 24.01.2024 duke anuluar procedurën e prokurimit “E hapur” me Nr. REF-93857-01-26-2024, me objekt “Shërbimet e përmirësimit dhe mirëmbajtjes së software-ve”, me fond limit 13,980,000.00 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 14.02.2024, nga autoriteti kontraktor Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Durrës Sh.A.

II.2. Nga informacioni i shkresës së mësipërme si dhe nga verifikimet në (SPE) rezulton se autoriteti kontraktor ka anuluar procedurën e prokurimit edhe në sistemin e prokurimit elektronik.

II.3. Sa më lart, Komisioni konstaton se autoriteti kontraktor e ka zbatuar vendimin nr. 214/2024 datë 24.01.2024 të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit “E hapur” me Nr. REF-93857-01-26-2024, me objekt “Shërbimet e përmirësimit dhe mirëmbajtjes së software-ve”, me fond limit 13,980,000.00 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 14.02.2024, nga autoriteti kontraktor Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Durrës Sh.A.

Për sa më sipër, mbështetur në nenet 30, 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenin 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “E hapur” me Nr. REF-93857-01-26-2024, me objekt “Shërbimet e përmirësimit dhe mirëmbajtjes së software-ve”, me fond limit 13,980,000.00 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 14.02.2024, nga autoriteti kontraktor Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Durrës Sh.A.
 2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaïd Myzyri

